

## **TERMA**

- **“Marrëdhënie intime”** është marrëdhënia ndër-personale që përfshin, intimitet fizik ose emocional;
- **“Viktimë”** është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni;
- **“Urdhër mbrojtjeje”** është urdhri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën, fëmijët dhe sipas rastit masa për rehabilitimin e dhunuesit;
- **“Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje”** është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate.
- **“Urdhri për Masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”**, është urdhri i arsyetuar dhe i lëshuar sipas parashikimeve të nenit 13/1 të këtij ligji, që përmban masat e menjëhershme për ndalimin e dhunës, që merren nga organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit, deri në marrjen e vendimit nga gjykata”.